



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren  
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt.	28.08.2019
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-309

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Mbështetur në dispozitat ligjore të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 dhe Udhëzimin administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Procedurat e Rekrutimit në sektorin publik në Republikën së Kosovës, Universiteti "Ukshin Hoti" shpallë:

## KONKURS

**Pozitën: Mjeshtër/shtëpiak**

**Nëpunësi mbikëqyrës:** Udhëheqësi i Divizionit për Infrastrukturë dhe Fumizim.

**Qëllimi i pozitës:** Kryerja e punëve teknike rutinore në objektet e Universitetit "Ukshin Hoti" si dhe mirëmbajtja, riparimi i paisjeve elektrike, mekanike dhe hidrosanitare.

**Detyrat kryesore:**

- Të kryej riparime të vogla dhe të mbikqyrë riparimet e mëdha të objekteve dhe pajisjeve ose sistemeve sipas shkathtësive dhe përvojës specifike siq janë: punë elektrike, punë mekanike dhe punë hidrosanitare etj.
- Të bëjë riparime tjera të përgjithshme dhe të bëjë mirëmbajtjen e hapësirave të brendshme dhe të jashtme në kampusin e UUHP-së.
- Të riparoj ose zëvendësoj pajisjet elektrike, mekanike, hidrosanitare etj.
- Të mbikqyrë punën e përditshme të sistemit të ngrohjes dhe ftohjes së sistemit, sistemit elektrik.
- Të përciellë punën e gjeneratorit dhe kalldajës së ngrohjes qëndrore dhe të mbaj evidentë mbi rezervet me derivate dhe lëndë djekse.
- Të bëjë instalimin e sistemeve të reja si: Sistemeve elektrike dhe shtrirjen e kabllave të IT-së apo instalime tjera.
- Ti përgjigjet me kohë dhe në mënyrën më të mirë të gjitha kërkesave emergjente që mund të paraqiten si "shtëpiak".
- Të realizoj kontrollin ditor, javor dhe mujor në objekte, të raportoj problemet si dhe të kryej edhe detyra tjera në pajtim me vendin e punës siq kërkohet nga ana e mbikqyrësit.

**Shkathtësitë e kërkuara:**

- Njohuri të mira në elektrikë, mekanikë dhe hidrosanitari etj.
- Aftësi për të planifikuar punët dhe detyrtar e punës si dhe për të menaxhuar në situata emergjente.
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion.
- Aftësi të mira fizike dhe shëndet të mirë.

**Kohëzgjatja e kontratës:**

Kontrata lëshohet në përputhje me dispozitat e nenit 10 të ligjit të punës nr. 03/L-212. Puna provuese 6 muaj.

**Kushtet:**

*Të ketë të kryer shkollën e mesme,*

*Të jetë i certifikuar sipas nenit 10 paragrafi 3 të ligjit nr. 04/L-161 për sigurinë në punë,*

*Të jetë i certifikuar sipas nenit 11 paragrafi 3 të ligjit nr. 04/L-161 për dhënien e ndihmës së parë, evakuim-shpëtim,*

*Vërtetimin mbi gjendjen shëndetësore jo më të vjetër se 3 muaj,*

*Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.*

**Dokumentet:**

- Kërkesë për punësim
- Diploma dhe certifikata (kopja e vërtetuar te Noteri),
- Dëshmitë për provojnë e punës (profesionale),
- CV-në (biografinë)
- Certifikatën e lindjes,
- Letërnjoftimin- fotokopje,
- Certifikatën penale (dëshminë që nuk jeni nën hetime).

**INFORMATË E PËRGJITHSHME:**

Procedura e konkurimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret ligjore si dhe kriteret e këtij konkursi. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit, duke filluar nga data 28.08.2019 deri më 11.09.2019 ora 16:00 që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Universiteti ofron mundësi të barabarta për të gjithë pa asnjë lloj diskriminimi. Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 03/L-212 dhe UA nr.07/2017 për procedurat e rekrutimit në sektorin publik. Dokumentacioni dorëzohet në çdo ditë pune deri në mbylljen e këtij konkursi duke filluar nga ora 08:00-16:00.

Aplikacionet e pranura pas afatit të përcaktuar konsiderohen të pranueshme, nëse data në dërgesën postare, ose çfardo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.